

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Certifikimi i Postës Sipas ISO 27001”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të dokumentimit dhe certifikimit ligjor

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë, pa TVSH

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 8 (tetë) muaj kalendarik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës llimit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 39% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 19% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 19 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë një organizëm i vlerësimit të konformitetit për sistemet e manaxhimit dhe duhet të jetë aktualisht i akredituar për lëshimin e certifikatës ISO 27001 nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe të ketë kaluar me sukses dy cikle akreditimi të vërtetuara me certifikata akreditimi.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 77 pika 2, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 pika 4 dhe pika 6 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nëpërmjet të cilit kërkohet që operatori ekonomik të jete i akredituar/licencuar për ofrimin e shërbimit të certifikimit për ISO 27001/2013 nga organet kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kalimi me sukses i dy cikleve të akreditimit dëshmon se kompania ka qëndrueshmëri dhe seriozitet në ofrimin e shërbimit dhe rrit garancinë e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të shërbimit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij staf teknik jo më pak se 10 persona në listpagesat e 3 muajve të fundit, nga të cilët:

- a) Të ketë në përbërjen e tij staf teknik (Auditor/Lead auditor, jo më pak se 5) me eksperiencë në konsulencë apo auditimi mbi standardin ISO 27001 (kontratat dhe CV e personelit).

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me parashikimet e nenit 41, pika 4 dhe pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet komponente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Kriteri i mësipërm në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, AK vlerëson se duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, dhe volumin e lartë të punës që do të realizohet për auditimin e kompanisë e cila përfshin 2 site fizike me një numër rreth 86 punonjësish, shfaqet e nevojshme që kompania të ketë në stafin e saj teknik të pakten 10 (dhjetë) ekspertë nga të cilët minimumi 5 prej tyre të jenë tij (Auditor/Lead auditor për ISO 27001).

Numri i punonjësve të siguruar është vendosur në përputhje me volumin e shërbimit si dhe afatin e ekzekutimit të kontratës dhe ky numër punonjësish është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me sukses të saj. Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike. Ky kriter është bazuar në nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në konsulencë dhe auditime për ISO 27001 si në Shqipëri edhe në Vende të Komunitetit Europian (kontrata me kompanitë klientë).

Argumentimi: Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë se disponojnë eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare në auditime dhe certifikime për standardin ISO 27001/2013 dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës duke marrë në konsideratë se ky shërbim do të ofrohet për infrastrukturën kritike të informacionit. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbej autoritetit në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.5 Operatorit Ekonomik të ketë eksperiencë në auditimin e kompanive të ngjashme si dhe të kompanive shtetërore që janë pjesë e infrastrukturave kritike të informacionit sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 41, pika 3 dhe nenit 55, pika 4/b., të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi është në të drjtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesat të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta zbatuar kontratën.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kërkuar vërtetimin për realizimin e kontratave të ngjashme ne infrastuktura kritike te informacionit, në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur për të vërtetuar që ofertuesi pjesëmarrës ka përvojën e duhur, ka kapacitetet e duhuara si teknike dhe organizative për të realizuar një kontratë të tillë. Paraqitja e vërtetimit për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme nga ana e Operatorit Ekonomik dëshmon me korrëktësi në përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore të Operatorit Ekonomik në raste të tjera të ngjashme si në cilësi ashtu dhe në afatet duke krijuar besueshmëri te Autoriteti Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik të ketë nje aktivitet ne Shqipëri në fushën e certifikimeve të standardeve ndërkombetare jo me pak se 10 vjet.

Argumentimi: Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën të konsoliduar në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës duke marrë në konsideratë se ky shërbim do të ofrohet për infrastrukturën kritike te informacionit.

2.3.7 Për instruktorin e trajnimit kërkohet të përmbushen edhe këto kualifikime personale:

- Certifikatë si Lead Auditor për ISO 27001, trajnime me provime dhe të njohura nga organizma certifikues.
- Të paktën 5 vjet përvojë si Lead Auditor për ISO 27001.
- Të paktën 10 vjet përvojë në njohjen dhe zbatimin e sistemeve të manaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 (përvoja si konsulencë, apo si përgjegjës sistemi të manaxhimit të sigurisë informatike).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Lidhur me certifikatën e sipërcituar Lead Auditor për ISO 27001/2013, sqarojmë se vendosja e këtij kriteri gjen mbështetje dhe u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41 dhe 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Certifikatë duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike dhe staf te certifikuar për te realizuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë staf me certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

Përvoja, 5 vjeçare si Lead Auditor per ISO 27001 e instruktorit dhe eksperiencia 10 vjeçare ne njohjen dhe zbatimin e sistemeve te menaxhimit te sigurisë se informacionit është vendosur duke pasur ne konsiderate rëndësinë e implementimin te standardit te sigurisë ne infrastrukturën kritike dhe eksperiencën qe duhet te kenë instruktori për realizimin e trajnimit të stafit përgjegjës per implementimin dhe mirëmbajtjen e standardit te sigurisë se informacionit ne infrastrukturën kritike Posta Shqiptare.

*Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***”*

*Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paragesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.**”*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 13.11.2023, ora 10:00.

Njësia e Prokurimit